



**KOSOVO  
CSR  
NETWORK**

Anëtare e:   
**CSR  
EUROPE**

BULETINI INFORMATIV

# RRJETI CSR KOSOVA

Tetor 2018



Rruga "Tringë Smajli", nr. 21  
Prishtinë, Kosovë 10000

E-mail: [info@csrkosovo.org](mailto:info@csrkosovo.org)  
Telefon: +383 38 712 715

Na gjeni në:  
Web: [csrkosovo.org](http://csrkosovo.org)

Facebook & LinkedIn:  
Kosovo CSR Network

Instagram:  
[csrkosova](https://www.instagram.com/csrkosova)



## “COCA-COLA PËRKRAH RININË”, FILLOI IMPLEMENTIMIN E FAZËS SË DYTË TË PROGRAMIT

Programi për fuqizimin e të rinjve “Coca-Cola përkrah Rininë”, njëherit më i madhi në Kosovë, filloi pjesën e dytë të implementimit. Konkretisht ky program ka për qëllim aftësimin e 300 të rinjve për treg të punës dhe vetëpunësim. Të gjithë të rinjtë që do të marrin pjesë në këtë program, do të kenë mundësinë të trajnohen në zhvillim të aftësive si menaxhimi i kohës dhe projekteve, informata kthyesë, se si të komunikohen përparësitë dhe arritjet në mënyrë efektive, komunikimi biznesor dhe etika në biznes etj. Programi ka një moto e ajo është “Mëso, zbato, vepro” dhe me shumë përgjegjësi mund të them se ja kemi dalë së zbatuari. Këtë e konfirmon fakti se në fazën e parë të programit që është implementuar në muajt Prill - Maj të këtij viti, është arritur që më shumë se gjysma e pjesëmarrësve të kenë rezultate konkrete, duke filluar punë praktike apo punësim. Jo vetëm kaq ngase numri i rezultateve konkrete po shtohet çdo javë.



# Muaji për Ndërgjegjësimin e Kancerit të Gjirit



Tetori është Muaji i Vetëdijësimit të Kancerit të Gjirit, një fushatë botërore që përfshin mijëra organizata dhe kompani. Anëtarët e rrjetit CSR Kosova i janë bashkangjitur nismës për të theksuar rëndësinë e ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit. Korporata Rugove lansoi etiketën me moton Zbulimi i hershëm i kancerit të gjirit – Mbijetesë për të rritur vetëdijësimin, me që vetëm zbulimi i hershëm sjellë mbijetesë, jetë më kualitative dhe shpenzime më të vogla të trajtimit.

Më 20 Tetor në Prishtinë u mbajt manifestimi vetëdijësues kundër kancerit të gjirit ku bashkëorganizatorë ishin Korporata Rugove. Përgjatë këtij muaji Korporata Rugove u bashkangjiti në tubimet e hapura në shtatë komuna të Kosovës me qëllim të shpërndarjes së informatave për rrezikun e kancerit të gjirit dhe mënyrat e zbulimit të hershëm. Gjithashtu, Korporata Rugove tashmë ka instaluar aparate uji në Institutin Onkologjik të Kosovës dhe ka filluar furnizimin me ujë në këtë institut për pacientët, familjarët dhe personelin që kujdeset për pacientë

# Mbështetja e Anëtarëve të CSR për "Let's Dance"



Kompanitë anëtare të Rrjetit CSR Kosova përfshirë Raiffeisen Bank, Coca Cola HBC, ProCredit Bank, Kostt, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, Meridian Express dhe Recura kanë mbështetur ngjarjen vjetore "Let's Dance", ku të gjitha fondet e ngritura nga biletat dhe donacionet do të mbështesin nënat dhe fëmijët në Kosovë përmes programeve të Fondacionit Akcioni për Nëna dhe Fëmijë, duke u dhënë fëmijëve një shans për një jetë të shëndetshme dhe të lumtur.



01 Nëntor, 2018 ora 20:00h, në Sheshin 21



# MEET OUR MEMBER- RECURA FINANCIALS

Intervistë me Visar Dobroshin, Partner Menagjues

## Çfarë shërbime ofron RECURA?

RECURA është ofrues Kosovar i shërbimeve këshilluese i fokusuar në ofrimin e konsulencës për biznese, të natyrës financiare dhe menaxhimit në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. RECURA ofron një gamë të gjerë të shërbimeve të veçanta të konsulencave për sektorin privat në fushën e Financave Korporative, Biznesit, Menaxhimit, Qeverisjes Korporative (në partneritet me IFC – Banka Botërore) dhe konsulencë inxhinerike, si edhe për Sektorin Publik në Menaxhimin dhe Qeverisjen e Financave Publike. RECURA ka në kuadër të saj ekspertë të fushës së financave, ekonomisë, biznesit dhe menaxhimit, të arsimuar në universitetet kulminante në Mbretërinë e Bashkuar dhe ShBA, me një përvojë të gjatë në Kosovë si dhe përvojë ndërkombëtare. Portfolio e klientëve të RECURA dhe portfolio e shërbimeve këshillimore përfshinë një thesar të njohurive dhe përvojave si në sektorin publik dhe atë privat.

## Planet e RECURA FINANCIALS për të ardhmen?

RECURA synon të vazhdojë me rritjen e kompanisë, si me produkte të reja ashtu edhe me zgjerim gjeografik në regjion. Natyrisht, kjo rritje nënkupton rritjen e kapaciteteve njerëzore si në numër ashtu edhe në trajnim të vazhdueshëm të stafit. Synimi ynë ka qënë dhe mbetet në krijimin e ambientit të dëshirueshëm për punë dhe bashkëpunim, si për stafin e brendshëm ashtu edhe për të gjithë partnerët dhe partneritetet që i kultivojmë.

## Aktivitetet e CSR?

Aktiviteti i fundit që kemi ndërmarrë ka qënë pjesëmarrja në ngjarjen vjetore “Let’s Dance” që këtë vit është mbajtur për herë të katërt me 1 Nentor 2018. Kjo ngjarje organizohet nga organizata “Action for Mothers and Children” misioni i të cilës është të avokojë fuqishëm për kujdes shëndetësor më të mirë për gratë dhe fëmijët në tërë Republikën e Kosovës, të studiojnë problemet e tyre shëndetësore dhe sistemet e kujdesit shëndetësor që adresojnë këto probleme dhe të ndihmojnë nënat që të kenë shtatëzani të shëndetshme dhe të shpëtojmë jetën e fëmijës. Si gjithë viteve të kaluara edhe kete here Recura ishte sponsor në këtë ngjarje ku kemi kontribuar me një shumë prej 1500 EUR. Sivjet, stafi i Recura ka kontribuar në fushata të dhënies vullnetare të gjakut si dhe në fushata të donacioneve për libra e material shkollor për fëmijë të familjeve skamnore.



## **Rreth bashkëpunimit të RECURA me Rrjetin CSR Kosova?**

**Ne mbesim të interesuar të jemi sa më aktiv në gjetjen e mundësive për të dhënë kontribut në shoqëri, pra, që një pjesë të arritjeve dhe angazhimeve tona t'ia kthejmë shoqërisë ku jetojmë e punojmë. Prandaj, bashkëpunimi i ngushtë me CSR Kosova për ne është i një rëndësie të veçantë dhe planifikojmë që këtë bashkëpunim ta rrisim edhe më shumë në të ardhmen.**

**Kosovo CSR Network tashmë është dëshmuar si përfaqësuese e denjë e artikullimit dhe angazhimit në ngritje të vetëdijes për përgjegjësi shoqërore të korporatave dhe mendojmë që duhet vazhduar dhe rritur angazhimin në këtë drejtim. Në këtë mënyrë do të rritet vetëdija e korporatave për përgjegjësi shoqërore që të kontribuojnë edhe më shumë në ngritjen e mirëqenjes në shoqëri, posaqërisht për grupe të caktuara të shoqërisë që kanë qasje të kufizuar në të mirat apo në plotësim të nevojave të domosdoshme për mirëqenie.**

**Rrjeti CSR Kosova duhet të jetë sa më afër kompanive por edhe grupeve me nevoja për asistencë dhe të jetë vazhdimisht në kërkim të aktiviteteve inovative për asistencë dhe përfshirje sa më të madhe të të gjitha grupeve në aktivitete të saja.**

# MERIDIAN EXPRESS ME KAMPANJËN “BARAZO FATURËN” MBËSHTET FËMIJËT E SOS FSHATIT PËR TË PESTIN VIT ME RADHË

Për vitin e pestë me radhë rrjeti i marketeve të lagjes në Kosovë, Meridian Express në partneritet me SOS Fshatrat e Fëmijëve vazhduan fushatën tradicionale ”Barazo Faturën”. Përmes kësaj fushate të gjithë konsumatorët e Meridian Express kanë pasur mundësinë të kontribuojnë për SOS Fshatin në gjithë rrjetin e dyqaneve të Meridian Express.


Pas çdo blerje që bëjnë , konsumatorët kanë mundësi të barazojnë faturën, duke dhuruar shumën e mbetur nga fatura për SOS Fshatin. Për hir të transparencës së kampanjës, konsumatorët pranojnë faturën fiskale ku secila shumë e dhuruar figuron në formë të produktit. Gjatë kësaj kampanje, këtë vit janë mbledhur 3,622.35€. Kjo iniciativë nga Meridian Express dhe konsumatorët e saj, tashmë është bërë traditë gjatë viteve të fundit.



Meridian Express vazhdon të jetë njëra nga kompanitë më të suksesshme në Kosovë dhe këtë e dëshmon dhe çmimi për filantropi, ai i “FIDES – në nivel korporativ si dhe antarësimi i saj në nivel të grupit në Forumin Ekonomik Botëror.

# TAKIMI I ORGANIZATAVE PARTNERE NË VARSHAVE, POLONI

**Drejtorja e Rrjetit CSR Kosova, Linda Tahiri, morri pjesë në takimin e Organizatave Partnere të CSR Europe në Varshavë të Polonisë, ku u diskutua Strategjia e Përgjegjësisë Shoqërore të Evropës deri në vitin 2030. Pikat kyçe që u diskutuan ishin: cili do të ishte një sukses i vërtetë për organizatën dhe vendin tonë në lidhje me qëndrueshmërinë; a është ky drejtimi i duhur për 10 vitet e ardhshme; cilat mjete / mbështetje / shërbime që organizatat partnere kanë nevojë për të rritur bashkëpunimin dhe për të zbatuar strategjinë.**



# TURNEU I FUTBOLLIT "JOHN MCCAIN"

AmChamKosovo organizoi turneun e futbollit John McCain për bamirësi, duke nderuar miqësinë midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës, ndërsa qëllimi i kësaj ngjarjeje bamirësie ishte të ndihmonte SOS fshatin në Kosovë. Ky turne u organizua me mbështetjen e Entermedia.

## John McCain Charity Football Tournament



# SDG MASTERCLASS

CSR Europe ka organizuar trajnim për udhëheqësit e organizatave anëtare të CSR Europe, ku bën pjesë edhe Rrjeti CSR Kosova, për t'i aftësuar që vet udhëheqësit të jenë trajnerë për të tjerët.

## Përfitimet për kompanitë që trajtojnë SDG-të

- Përmirësimi i markës dhe përparësia konkurruese
- Tërheq investitorët
- Nxitja e inovacionit
- Gjeni mundësitë e tregut të krijuara duke adresuar SDG-të
- Modele të reja të biznesit, të shtuara nga teknologjia dhe të fokusuara në rezultate të qëndrueshme
- Përmirësim i përvojës dhe angazhimit të konsumatorëve
- Mbajtja e licencës për të vepruar nëpërmjet veprimeve në përgjegjësitë dhe detyrimet sociale
- Efikasiteti i brendshëm operacional, përmirësimet e procesit dhe kursimet potenciale të burimeve dhe kostove

Klasa për SDG siguroi praktikuesit e kompanisë me një kurs interaktiv dhe praktik mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Pjesëmarrësit paten rastin të mësojnë se çfarë janë të gjitha SDG-të dhe a janë me kapacitet për të filluar / avancuar veprimet drejt SDG-ve në organizatat e tyre.



# KOSOVO CSR NETWORK

Ky buletin u punua nga Kosovo CSR Network

